



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 663 Prot.

Tiranë, më 30 / 01 / 2023

URDHËR

Nr. 125 datë, 30 / 01 / 2023

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR MARRJEN NË DORËZIM TË
REGJISTRAVE, AKTEVE NOTERIALE DHE VULAVE TË ISH NOTERIT BASTRI
MEÇAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 2, të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 72, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 168 datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të arkivave të pa dorëzuara ndër vite”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 2611, datë 04.04.2006 “Për Heqjen e Lejes së Ushtrimit të profesionit të Noterit”, të Ministrit të Drejtësisë,

KONSTATOJ:

Spektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, pasi kreu verifikimin në regjistrin e noterëve, evidentoi se ish noterit Bastri Meçaj i është hequr licenca e ushtrimit të profesionit të noterit me Urdhrit nr. 2611, datë 04.04.2006 “Për Heqjen e Lejes së Ushtrimit të profesionit të Noterit”, të Ministrit të Drejtësisë dhe në regjistër nuk ka të dhëna mbi noterin që ka marrë në dorëzim arkivin.

Nga Spektori i Arkiv Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë u kryen verifikimet përkatëse dhe u nxorr nga arkiva urdhri i Ministrit të Drejtësisë për heqjen e licensës për ushtrimin e profesionit të noterit, i cili përmban dhe detyrimin e dorëzimit të arkivit dhe vulave noteriale si dhe për marrjen në dorëzim të arkivave të ish-noterëve.

Nga verifikimi i kryer, lidhur me arkivin noteriale të ish-noterit Bastri Meçaj nuk rezulton që nga ana e komisionit të jenë marrë masa për marrjen në dorëzim të arkivit parashikuar në pikën 3, të Urdhrit Ministrit të Drejtësisë, nr. 2611, datë 04.04.2006 “Për Heqjen e Lejes së Ushtrimit të profesionit të Noterit”, të Ministrit të Drejtësisë, të jenë marrë masa për marrjen e kësaj arkivi dhe asgjësimin e vulave të noterit.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni të ri për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish noterit Bastri Meçaj, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mos pengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivin e ish noterit, si dhe asgjësimin e vulës së thatë dhe të njomë të ish-noterit.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, si dhe Urdhrin nr. 168 datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe Marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ndër vite”,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 6, pika 18/1 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 72, pika 1, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar; si dhe pikës “3” dhe “7”, të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,


URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të ish noterit Bastri Meçaj, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Matilda Hoxha, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
 - b) Znj. Diana Toro, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
 - c) Znj. Sonja Memoçi, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Përmbartimore Private;
 - c) Znj. Albana Hoti, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë;
 - c) Znj. Edlira Nishani, anëtar i Dhomës Vendore të Noterisë Durrës.
2. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të të ndjerit ish noterit Bastri Meçaj.
3. Arkiva merret në dorëzim me procesverbal dhe në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Degën Vendore të Noterisë Durrës.
4. Arkiva t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Durrës, znj. Aida Spahiu, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteria plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori Arkiv – Protokollit të kryejë veprimet e nevojshme për të mbështetur kryerjen dhe marrjen në dorëzim të arkivit, për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
8. Ngarkohet Drejtoria TIK, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, për kthimin në statusin inaktiv nga Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH), të ish noterit, të ndjerit Bastri Meçaj.
9. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë, për kthimin në statusin inaktiv të ish noterit, të ndjerit Bastri Meçaj, në Sistemi Elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë (në vijim, sistemi elektronik i Dhomës), në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik publik përkatës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



Ulsi Manja

